



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.416/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Hajriz Hoti dhe Violeta Rugova Husaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Besnike Fazliu, Fatmir Baliu, Murat Bylykbashi dhe Bekim Lestrani, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komuna Gllogoc, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të paraqitura kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me nr. 01/3243-2025 të datës 05.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për kuvend komunal në Gllogoc, për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me **10.11.2025**, merr këtë:

V E N D I M

I. PRANOHEN të bazuara ankesat ZL.Anr.416/2025, ZL.Anr.417/2025, ZL.Anr.419/2025 dhe ZL.Anr.422/2025, të datës 07.11.2025, të parashtruara nga Besnike Fazliu, Fatmir Baliu, Murat Bylykbashi dhe Bekim Lestrani, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komuna Gllogoc, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të paraqitura kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me Nr.01/3243-2025 të datës 05.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për kuvend komunal në Gllogoc, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, ashtu që **URDHËROHET** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumërojë të gjitha fletëvotimet për kandidat për Kuvend Komunal në Gllogoc nga në vendvotimet: 0324/01, 0325/01, 0322/01, 0320/01, 0318/02, 0317/04, 0317/03, 0316/02, 0312/02, 0310/03, 0310/02, 0304/01, 0321/01, 0324/03, 0327/01, 0315/02, 0316/01, 0308/01, 0307/02, 0306/01, 0301/05, 0301/04, 0328/02, 0326/03, 0311/03, 0304/03, 0307/01, 0305/01, 0302/01, 0313/02, 0313/03, 0322/0, 0323/02, 0311/01, 0330/01, 0304/02, 0317/01, 0317/02, 0324/02, 0309/01, 0309/02, 0310/05, dhe 0313/01, dhe të njëjtat pastaj të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

II. REFUZOHET e pa bazuar ankesa, lidhur rinumërimin e fletëvotimeve Nr.0305/02, 0327/01 dhe 0329/02.

Arsyetim

Me datën 07.11.2025, PZAP-i ka pranuar ankesat ZL.Anr.416/2025, ZL.Anr.417/2025, ZL.Anr.419/2025 dhe ZL.Anr.422/2025, të parashtruara nga Besnike Fazliu, Fatmir Baliu, Murat Bylykbashi dhe Bekim Lestrani, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komuna Gllogoc, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të paraqitura kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me nr. 01/3243-2025 të datës 05.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për kuvend komunal në Gllogoc, për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në të cilat pretendohet se ka pasur parregullsi të shumta gjatë procesit të numërimit. Sipas parashtruesve të ankesave, ka dyshime të bazuara se votat e raportuara si të paplotësuara në vendvotime mund të jenë plotësuar më pas në QNK, në favor të ndonjë kandidati për Kuvend Komunal, ndërsa numri i votave të pavlefshme është rritur në mënyrë të pashpjegueshme, gjë që mund të ketë ndikuar negativisht në rezultatin për kandidatë të caktuar. Këto mospërputhje përbën provë konkrete për ndërhyrje të mundshme gjatë përpunimit të të dhënave dhe kërkojnë verifikim të detajuar të çdo kutie votimi. Pastaj mungesa e nënshkrimeve të disa komisionerëve në formularët e QNK, i cili pretendim sipas parashtruesve të ankesave, përputhet me raportin zyrtar të KQZ.

Më tej në ankesa theksohet se gjetjet konkrete të vëzhguesve të pranishëm gjatë procesit të numërimit në QNR, komunikimet dhe kërkesat zyrtare të përfaqësuesve të subjektit politik ndaj Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) dhe zyrtarëve të KQZ-së si dhe në dokumentacionin dhe formularët zyrtarë të QNK-së, të cilët dëshmojnë për mospërputhje ndërmjet rezultateve të QNK-së dhe QNR-së, mangësi në nënshkrime të formularëve, si dhe mungesë të transparencës gjatë procesit të rinumërimit. Kërkojnë nga PZAP-i që të urdhëroj KQZ-në, për Rinumërim e fletëvotimeve në Vendvotimet në Komunën e Drenasit, të ndara sipas kategorive të parregullsive të evidentuara: - Të rinumërohen vendvotimet me mospërputhje të votave të paplotësuara dhe të pavlefshme për Kuvende Komunale në mes formularëve të Qendrave të votimit (vendvotimeve) me formularët e QNK-së. Kodi i vendvotimeve të përfshira: 0329/02, 0327/01, 0324/01, 0325/01, 0322/01, 0320/01, 0318/02, 0317/04, 0317/03, 0316/02, 0312/02, 0310/03, 0310/02, 0309/02, 0304/01. -Të rinumërohen vendvotimet në të cilat mungojnë nënshkrimet e pjesëmarrësve në numërim dhe nuk janë nënshkruar në formular në pjesën ballore, Kodi i vendvotimeve të përfshira: 0321/01, 0320/01/ 0322/01, 0324/03, 0327/01, 0315/02, 0316/01, 0308/01, 0307/02, 0306/0, 0301/05, 0301/04, 0328, 0326/03, 0312/02, 0311/03, 0304/03. -Të rinumërohen vendvotimet me mungesë të nënshkrimit në fletën e fundit të formularëve. Vendvotimet e përfshira: 0321/01, 0315/02, 0308/01, 0307/01, 0305/01, 0302/01, 0301/05, 0301/04, 0304/03, 0311/03, 0313/02, 0328/02, 0312/02. Si dhe Vendvotimet: 0307/02, 0310/03, 0313/03, 0322/01, 0323/02, 0311/01, 0330/01, 0304/02, 0304/01, 0316/02, 0318/02, 0317/01, 0317/02, 0317/03, 0317/04, 0324/01, 0324/02, 0309/01, 0309/02. -Vendvotimet 0310/02, 0310/05, 0313/01 dhe 0313/02.

Në përgjigjen në ankesë KQZ sqaron se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/1.228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, NI-

,01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). Andaj, bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet e Zgjedhore nenin 9 paragrafi 1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cilit do VV, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV.

KQZ gjithashtu njofton se, procesi i numërimit të votave në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr. 14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) ku ekipet e numërimit kanë bërë nurnërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar. KQZ, në përputhje me nenin 6, paragrafi 1.5 dhe 1.9, nenin 15 paragrafi 3 dhe nenin 20 paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), KQZ me datën 22.10.2025, ka marrë vendim Nr.01/2979/2025, për miratimin e rekomandimit të QKN për rinumërimin e gjashtëmbëdhjetë (16) vendvotime, të cilat kanë pasur mospërputhje midis numrit të nënshkrimeve në Listën Përfundimtare të Votuesve (LPV) dhe numrit të fletëvotimeve brenda kutisë së votimit, për zgjedhjet lokale të Republikës së Kosovës të mbajtura me 12 tetor 2025, (shih të bashkangjitur vendimin për miratimin e rekomandimit të QNR),

Ndërsa më datën 24.10.2025 ka marrë vendimin me nr. të protokollit 01/3006/2025 për Miratimin e Rekomandimit pas Procesit të Rinumërimit në QNR, ku ndër vendvotimet e rinumëruara kanë qenë edhe vendvotimet e komunës së Glllogocit: nr. 0305/02, 0327/01 dhe 0329/02 në komunën e Glllogocit. Pas rinumërimit kanë rezultuar se në vendvotimin 0305/02 mospërputhja e rezultateve pas rinumërimit nuk ka ekzistuar, në vendvotimin 0327/01 është rritur toleranca +-1, në mënyre që vendvotimi të procedohet si i rregullt, ndërsa në vendvotimin 0329/02 pas rinumërimit të kutisë tek fletëvotimet e pavlefshme është gjetur një fletëvotim me pak sesa numri i shënuar në QKN dhe kështu më nuk ekziston diferenca.

Pala ankuese, ndër të tjera, ka pretenduar se disa nga familjarët, votues kanë votuar për të, mirëpo, sipas saj mungojnë votat e tyre. Ky pretendim nuk mund të vërtetohet, pasi që vota është e fshehtë dhe, në përputhje me parimet e fshehtësisë dhe lirisë së votës, dhe po ashtu në fletëvotim nuk mund të identifikohet emri i votuesit. Sa i përket pretendimeve të palëve ankuese e cila mbështetet në pritshmërinë dhe deklaratimet e personave, dhe familjareve të tij, duhet theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit.

Gjithashtu, pala ankuese në ankesën e saj ka ngritur pretendime që lidhen me administrimin e punës në Qendrën e Komunale të Numërimit (QKN). Sipas nenit 105 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ankesat që kanë të bëjnë me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i ndodhjes së shkeljes së supozuar. Andaj, KQZ ju njofton se procesi i numërimit dhe administrimit të punës së QKN në komunën e Glllogocit ka përfunduar me datë 18.10.2025 në ora 11:00. KQZ, ju njofton se i

gjithë materiali zgjedhor, (duke përfshirë kamerat e sigurisë, Librat e Votimit dhe Formularët) gjenden në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve –QNR dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

Paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat ZL.Anr.416/2025, ZL.Anr.417/2025, ZL.Anr.419/2025, dhe ZL.Anr.422/2025, të datës 07.11.2025 të njëjtat janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë të përbashkët ZL.A.nr.416/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore, përgjigjet në ankesë ka gjetur se:

- Ankesat janë të bazuara.

Paneli vlerësoi se pretendimet e parashtruara në ankesat ZL.Anr.416/2025, ZL.Anr.417/2025, ZL.Anr.419/2025 dhe ZL.Anr.422/2025, të datës 07.11.2025, të parashtruara nga Besnike Fazliu, Fatmir Baliu, Murat Bylykbashi dhe Bekim Lestrani, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komuna Gllogoc, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), provat e parashtruara dhe nga përgjigjet në ankesë të KQZ, konstatoj se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që nga provat e administruara është vërtetuar se ka parregullsi dhe mospërputhje të nënshkrimeve dhe fletëvotimeve në kutitë e votimit në vendvotimet: 0324/01, 0325/01, 0322/01, 0320/01, 0318/02, 0317/04, 0317/03, 0316/02, 0312/02, 0310/03, 0310/02, 0304/01, 0321/01, 0324/03, 0327/01, 0315/02, 0316/01, 0308/01, 0307/02, 0306/01, 0301/05, 0301/04, 0328/02, 0326/03, 0311/03, 0304/03, 0307/01, 0305/01, 0302/01, 0313/02, 0313/03, 0322/0, 0323/02, 0311/01, 0330/01, 0304/02, 0317/01, 0317/02, 0324/02, 0309/01, 0309/02, 0310/05, dhe 0313/01 në Komunën e Gllogocit, kjo pasi që nga provat e bashkangjitura nga ankesat e kandidatëve të Subjektit Politik PDK, rezulton se në vendvotimet e lartcekura të Komunës së Gllogocit, ka pasur parregullsi tek fletëvotimet e paplotësuar, rritje të numrit të fletëvotimeve të pavlefshme, mungesë të nënshkrimeve të disa komisionerve në formularët e QNK, i cili pretendim përputhet me raportin zyrtar të KKZ, mospërputhje ndërmjet rezultateve të QNK-së dhe QNR-së, si dhe mungesë të transparencës gjatë procesit të rinumërimit.

Me dispozitën e nenin 15 pika 11.5 të Rregullës Zgjedhore Nr.12/2024 - Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit parashihet se “*Fletëvotimet rinumërohen për të vërtetuar nëse ka çfarëdo mospërputhje midis numrit të fletëvotimeve në kuti dhe numrit të nënshkrimeve në Listën e votimit*”. Po ashtu me dispozitën e nenit 20 par.3 të Rregullës Zgjedhore 14/2024- Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) parashihet se “*Në rast mospërputhjeje, me vendim të KQZ, Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) apo Gjykatës Suprem, rinumërohen fletëvotimet*”. Ndërsa në nenin 21 par.7 të Rregullës Zgjedhore 16/2024 - Qendrat Komunale të Numërimit parashihet se “*Anëtarët e*

*ekipit të numërimit shënojnë në formular të rezultateve numrat e shiritave mbyllës të kutisë së votimit dhe nënshkruhen në formular të rezultateve, të krijuara nga ekipi i numërimit”. Me dispozitën e nenit 106 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) Nr. 08/L-228, i cili decidivisht përcakton: *Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë cenuar me vendimin e KQZ-së, sa i përket shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, mund të parashtrojë ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga shpallja e tij*”.*

Bazuar në dispozitat e lartcekura dhe nga provat në shkresat e lëndës, Paneli ka gjetur se në të gjitha këto raste ka parregullsi, pasi që nga konstatimet e vet përfaqësuesit të KKZ është vërtetuar se në secilin ndërrim kanë marrë pjesë nga 9 ekipe me nga 4 anëtarë të cilët kanë qenë të[subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ndërsa në formularët e QNK-së në shumicën prej tyre janë nënshkruar nga tre, dy apo më pak persona. Po ashtu nga provat e bashkangjitura ka mospërputhje të votave të paplotësuara dhe të pavlefshme për Kuvende Komunale në mes formularëve të Qendrave të Votimit me formularët e QKN-së, e që të gjitha këto fakte e bëjnë të pavlefshëm procesin e numërimit, pasi që janë arsye të besueshme se ka pasur ndërhyrje apo parregullsi gjatë përpunimit të të dhënave.

Andaj, Paneli duke u bazuar në arsyet e dhëna dhe në të gjitha shkeljet e theksuara më lartë, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi, duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 të LZP-së Nr. 08/L-228, i cili decidivisht përcakton *“PZAP-ja mund të urdhërojë rinumërimin e fletëvotimeve në një vendvotim apo qendër votimi si dhe shqyrtimin e materialit votues si pjesë të hetimeve për ankesën e parashtruar”,* si dhe Rregullores Për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave Nr.01/2025, neni 13 *“në rast se PZAP konstaton se ka ndodhur shkelje e LZP-së dhe rregullave zgjedhore të KQZ-së para certifikimit të rezultateve zgjedhore është në kompetencë të PZAP që në raste të jashtëzakonshme:12.1. të urdhërojë KQZ-në që të rinumëroj fletëvotimet në një vendvotim apo qendër votimi”,* andaj në rrethana të tilla PZAP me qëllim të evitimit të shkeljeve dhe parregullsive që janë evidentuar në këto qendra të votimit gjatë numërimit të fletëvotimeve, ka urdhëruar rinumërimin e këtyre fletëvotimeve.

Paneli vlerëson se KQZ-ja përkundër që ka pasur mundësi që përmes përgjigjes në ankesë të parashtrojë prova dhe të argumentojë të kundërtën e pretendimeve të ankuesit, e njëjta nuk ka bashkangjitur asnjë provë për vërtetimin e pretendimeve të saj lidhur me parregullsitë e ndodhura në këto qendra të votimeve. Paneli ka vlerësuar deklaratimet e KQZ-së, se me vendimin e KQZ-së është urdhëruar rinumërimi në vendvotimet 0305/02. 0327/01 dhe 0329/02, nga ku kanë dal ndryshime në numrin e votave, e për të cilat në rastin konkret nuk është kërkuar rinumërimi në këtë rast, mirëpo sipas vlerësimit të Panelit kjo edhe më tepër e bazon qëndrimin dhe përbën edhe një fakt shtesë se numërimi në QKN nuk qenë i saktë dhe i rregullt.

Ndërsa sa i për ketë vendvotimeve me nr. 0305/02, 0327/01 dhe 0329/02 në komunën e Gllogocit, pas rinumërimit kanë rezultuar se në vendvotimin 0305/02 mospërputhja e rezultateve pas rinumërimit nuk ka ekzistuar, në vendvotimin 0327/01 është rritur toleranca +-1, në mënyre që vendvotimi të procedohet si i rregullt, ndërsa në vendvotimin 0329/02 pas

rinumërimin të kutisë tek fletëvotimet e pavlefshme është gjetur një fletëvotim me pak sesa numri i shënuar në QKN, Paneli vendosi të mos i rinumëroj pasi të njëjtat me vendimin e KQZ-së me Nr.01/2979-2025 të datës 22.10.2025, është bërë ri numërimi i fletëvotimeve dhe kështu që më nuk ekziston diferenca në mes të rezultateve, andaj dhe u vendos si në pikën II të dispozitivit.

Nga të gjitha këto arsye e duke u bazuar në dispozitat e nenit 106, neni 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së Nr.08/L-228, lidhur me nenin 13 par. 12.1 të Rregullores Për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave Nr.01/2025, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZL.Anr.416/2025, datë 10.11.2025

Kryesues i Panelit
Arsim Hamzaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimin të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.116/2025

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Faton Bajrami, kryetar, Milena Deric dhe Lumni Sallauka, anëtarë, duke vendosur në rastet e bashkuara sipas ankesave të Bekim Lestrani dhe Besnike Fazliu, kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Glllogocit, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të parregullsive në shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.416/2025, të datës 10.11.2025, në seancën e mbajtur më datë 14.11.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat e Bekim Lestrani dhe Besnike Fazliu, kandidatë për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Glllogocit, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të paraqitura kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, ZL.Anr.416/2025, të datës 10.11.2025.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa ZL.Anr.416/2025, të datës 10.11.2025, është vendosur: "I. PRANOHEN të bazuara ankesat ZL.Anr.416/2025, ZL.Anr.417/2025, ZL.Anr.419/2025 dhe ZL.Anr.422/2025, të datës 07.11.2025, të parashtruara nga Besnike Fazliu, Fatmir Baliu, Murat Bylykbashi dhe Bekim Lestrani, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komuna Glllogoc, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të paraqitura kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me Nr.01/3243 - 2025 të datës 05.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për kuvend komunal në Glllogoc, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, ashtu që URDHËROHET Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumërojë të gjitha fletëvotimet për kandidat për Kuvend Komunal në Glllogoc nga në vendvotimet: 0324/01, 0325/01, 0322/01, 0320/01, 0318/02, 0317/04, 0317/03, 0316/02, 0312/02, 0310/03, 0310/02, 0304/01, 0321/01, 0324/03, 0327/01, 0315/02, 0316/01, 0308/01, 0307/02, 0306/01, 0301/05, 0301/04, 0328/02, 0326/03, 0311/03, 0304/03, 0307/01, 0305/01, 0302/01, 0313/02, 0313/03, 0322/0, 0323/02, 0311/01, 0330/01, 0304/02, 0317/01, 0317/02, 0324/02, 0309/01, 0309/02, 0310/05, dhe të njëjtat pastaj të përfshihen në rezultatin përfundimtar. II.



REFUZOHEt e pa bazuar ankesa, lidhur rinumërimin e fletëvotimeve Nr.0305/02, 0327/01 dhe 0329/02”.

Kundër vendimit të lartpërmendur, kandidatët për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Gllogocit, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Bekim Lestrani dhe Besnike Fazliu, kanë paraqitur ankesa të veçanta, AA.nr.116/2025 dhe AA.nr.117/2025, mirëpo Gjykata Supreme për shkak të ekonomizimit të procedurës, e duke marrë parasysh faktin se ankesat e kandidatëve të lartcekur janë paraqitur ndaj vendimit të njëjtë të PZAP-së, ankesat i ka bashkuar, respektivisht i ka trajtuar me një vendim, nën shenjë e përbashkët AA.nr.116/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesve.

Kundër vendimit të lartpërmendur, kandidati për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Gllogocit, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Bekim Lestrani, në afat të lejuar ligjor ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, duke pretenduar se ka pasur mospërputhje në mes formularëve të vendvotimeve dhe atyre të QKN-së, në disa vendvotime në Komunën e Drenasit, e po ashtu ka pretendur se në procesin e rinumërimin të tri vendvotimeve të Drenasit në QNR, është konstatuar ndryshim i rezultateve brenda listës së kandidatëve për Kuvend Komunal, duke dëshmuar se QNR nuk ka kryer numërimin me saktësi, duke propozuar që Gjykata Supreme të aprovojë ankesën e kandidati për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Gllogocit, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Bekim Lestrani si të bazuar, të konstatoj shkeljet e KQZ-së gjatë procesit të numërimit dhe rinumërimin, të urdhëroj rivlerësimin e procesit të numërimit për vendvotimet e Drenasit me prezencë të detyrueshme të përfaqësuesve të subjekteve politike, të pezulloj zbatimin e vendimit të KQZ-së dhe PZAP-së deri në hetimin e plotë të procesit, dhe nëse konstatohen shkelje që ndikojnë në rezultatin zgjedhor, të urdhërohet rinumërim i plotë i votave për Komunën e Drenasit.

Ndaj vendimit të lartpërmendur ankesë ka paraqitë edhe kandidatja për anëtare të kuvendit komunal në Komunën e Gllogocit, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Besnike Fazliu, në afat të lejuar në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit, me pretendime të njëjta si të ankuesit të lartcekur, duke theksuar se vendimi i PZAP-së është kundërtshënës, e po ashtu ka pretenduar se KQZ nuk e ka pritur afatin e ankesave, mirëpo ka filluar rinumërimin e kutive të cekura si në dispozitiv të vendimit të PZAP, sepse bazuar në ligjet në fuqi, ankesa kundërt vendimeve të PZAP, e shtyjnë ekzekutimin e vendimit të PZAP. Andaj ka kërkuar nga Gjykata Supreme që lëndën ta kthej në rivendosje në mënyrë që të urdhërohet numërimi i tërësishëm i vendvotimeve në Komunën e Gllogocit, për të mbrojtur vullnetin qytetar, për të garantuar një proces dhe një qeverisje të besueshme për 4 vitet e ardhshme, sepse kjo formë parciale e trajtimit të rinumërimin nuk garanton vullnet të garantuar kushtetues.

PZAP në përgjigje në ankesën e paraqitur të kandidatëve për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Gllogocit, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Bekim Lestrani dhe Besnike Fazliu, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi



thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa e kandidatëve në fjalë të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi ZL.Anr.416/2025, të datës 10.11.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara.

Me datën 07.11.2025, PZAP-i ka pranuar ankesat ZL.Anr.416/2025, ZL.Anr.417/2025, ZL.Anr.419/2025 dhe ZL.Anr.422/2025, të parashtruara nga Besnike Fazliu, Fatmir Baliti, Mural Bylykbashi dhe Bekim Lestrani, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komuna Glllogoc, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të paraqitura kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me nr.01/3243- 2025 të datës 05.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për kuvend komunal në Glllogoc, për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në të cilat pretendohet se ka pasur parregullsi të shumta gjatë procesit të numërimit. Sipas parashtrueseve të ankesave, ha dyshime të bazuara se votat e raportuara si të paplotësuara në vendvotime mund të jenë plotësuar më pas në QNK, në favor të ndonjë kandidati për Kuvend Komunal, ndërsa numri i votave të pavlefshme është rritur në mënyrë të pashpjegueshme, gjë që mund të ketë ndikuar negativisht në rezultatin për kandidatë të caktuar. Këto mospërputhje përbëjnë provë konkrete për ndërhyrje të mundshme gjatë përpunimit të të dhënave dhe kërkojnë verifikim të detajuar të çdo kutie votimi. Pastaj mungesa e nënshkrimeve të disa komisionerëve në formularët e QNK, i cili pretendim sipas parashtrueseve të ankesave, përputhet me raportin zyrtar të KQZ.

Më tej në ankesa theksohet se gjetjet konkrete të vëzhguesve të pranishëm gjatë procesit të numërimit në QNR, komunikimet dhe kërkesat zyrtare të përfaqësuesve të subjektit politik ndaj Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) dhe zyrtarëve të KQZ-së si dhe në dokumentacionin dhe formularët zyrtarë të QNK-së, të cilët dëshmojnë për mospërputhje ndërmjet rezultateve të QNK-së dhe QNR-së, mangësi në nënshkrime të formularëve, si dhe mungesë të transparencës gjatë procesit të rinumërimit. Kërkojnë nga PZAP-i që të urdhëroj KQZ-në, për Rinumërim e fletëvotimeve në Vendvotimet në Komunën e Drenasit, të ndara sipas kategorive të parregullsive të evidentuara: - Të rinumërohen vendvotimet me mospërputhje të votave të paplotësuara dhe të pavlefshme për Kuvende Komunale në mes formularëve të Qendrave të votimit (vendvotimeve) me formularët e QNK-së. Kodi i vendvotimeve të përfshira: 0329/02, 0327/01, 0324/01, 0325/01, 0322/01, 0320/01, 0318/02, 0317/04, 0317/03, 0316/02, 0312/02, 0310/03, 0310/02, 0309/02, 0304/01. -Të rinumërohen Vendvotimet në të cilat mungojnë nënshkrimet e pjesëmarrësve në numërim dhe nuk janë nënshkruar në formular në pjesën ballore, Kodi i vendvotimeve të përfshira: 0321/01, 0320/01/ 0322/01, 0324/03, 0327/01, 0315/02, 0316/01, 0308/01, 0307/02, 0306/0, 0301/05, 0301/04, 0328, 0326/03, 0312/02, 0311/03, 0304/03. -Të rinumërohen vendvotimet me mungesë të nënshkrimit në fletën e fundit të formulaiëve. Vendvotimet e përfshira: 0321/01, 0315/02, 0308/01, 0307/01, 0305/01, 0302/01, 0301/05, 0301/04, 0304/03, 0311/03, 0313/02, 0328/02, 0312/02. Si dhe Vendvotimet: 0307/02, 0310/03, 0313/03, 0322/01, 0323/02, 0311/01, 0330/01, 0304/02, 0304/01, 0316/02, 0318/02, 0317/01, 0317/02, 0317/03, 0317/04, 0324/01, 0324/02, 0309/01, 0309/02. -Vendvotimet 0310/02, 0310/05.



0313/01 dhe 0313/02.

Në përgjigjen në ankesë KQZ ka sqaruar se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/1.228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, NI-01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QIM). Andaj, bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet e Zgjedhore nenin 9 paragrafi 1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cilit do VV, ose dhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV. KQZ gjithashtu ka njoftuar se, procesi i numërimit të votave në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr. 14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar. KQZ në përputhje me nenin 6, paragrafi 1.5 dhe 1.9, nenin 15 paragrafi 3 dhe nenin 20 paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore Nr.14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), KQZ me datën 22.10.2025, ka marrë vendim Nr.01/2979/2025, për miratimin e rekomandimit të QI< N për rinumërimin e gjashtëmbëdhjetë (16) vendvotime, të cilat kanë pasur mospërputhje midis numrit të nënshkrimeve në Listën Përfundimtare të Votuesve (LPV) dhe numrit të fletëvotimeve brenda kutisë së votimit, për zgjedhjet lokale të Republikës së Kosovës të mbajtura me 12 tetor 2025, (shih të bashkangjitur vendimin për miratimin e rekomandimit të QNR).

Ndërsa më datën 24.10.2025 ka marrë vendimin me nr. të protokollit 01/3006/2025 për Miratimin e Rekomandimit pas Procesit të Rinumërimit në QNR, ku ndër vendvotimet e rinumëruara kanë qenë edhe vendvotimet e komunës së Gllogocit: nr: 0305/02. 0327/01 dhe 0329/02 në Komunën e Gllogocit. Pas rinumërimit kanë rezultuar se në vendvotimin 0305/02 mospërputhja e rezultateve pas rinumërimit nuk ka ekzistuar, në vendvotimin 0327/01 është rritur toleranca ± 1 , në mënyrë që vendvotimi të procedohet si i rregullt, ndërsa në vendvotimin 0329/02 pas rinumërimit të kutisë tek fletëvotimet e pavlefshme është gjetur një fletëvotim me pak sesa numri i shënuar në QKN dhe kështu më nuk ekziston diferenca.

Pala ankuese, ndër të tjera, ka pretenduar se disa nga familjarët, votues kanë votuar për të, mirëpo, sipas saj mungojnë votat e tyre. Ky pretendim nuk mund të vërtetohet, pasi që vota është e fshehtë dhe, në përputhje me parimet e fshehtësisë dhe lirisë së votës, dhe po ashtu në fletëvotim nuk mund të identifikohet emri i votuesit. Sa i përket pretendimeve të palëve ankuese e cila mbështetet në pritshmërinë dhe deklaratimet e personave, dhe familjareve të tij, duhet theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit. Gjithashtu, pala ankuese në ankesën e saj ka ngritur pretendime që lidhen me administrimin e punës në Qendrën e Komunale të Numërimit (QKN). Sipas nenit 105 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës,



ankesat që kanë të bëjnë me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i ndodhjes së shkeljes së supozuar. Andaj, KQZ ju njofton se procesi i numërimit dhe administrimit të punës së QKN në komunën e Glllogocit ka përfunduar me datë 18.10.2025 në ora 11:00. KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor (duke përfshirë kamerat e sigurisë, Librat e Votimit dhe Formularët) gjenden në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve - QNR dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet e drejtësisë.

Paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat ZL.Anr.416/2025, ZL.Anr.417/2025, ZL.Anr.419/2025, dhe ZL.Anr.422/2025, të datës 07.11.2025 të njëjtat janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë të përbashkët ZL.A.nr.416/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të aplikuesit.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore, përgjigjet në ankesë ka gjetur se ankesat janë të pabazuara. Paneli vlerësoi se pretendimet e parashtruara në ankesat ZL.Anr.416/2025, ZL.Anr.417/2025, ZL.Anr.419/2025 dhe ZL.Anr.422/2025, të datës 07.11.2025, të parashtruara nga Besnike Fazliu, Fatmir Baliu, Murat Bylykbashi dhe Bekim Lestrani, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komuna Glllogoc, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), provat e parashtruara dhe nga përgjigjet në ankesë të KQZ, konstatoj se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që nga provat e administruara është vërtetuar se ka parregullsi dhe mospërputhje të nënshkrimeve dhe fletëvotimeve në kutitë e votimit në vendvotimet: 0324/01, 0325/01, 0322/01, 0320/01, 0318/02, 0317/04, 0317/03, 0316/02, 0312/02, 0310/03, 0310/02, 0304/01, 0321/01, 0324/03, 0327/01, 0315/02, 0316/01, 0308/01, 0307/02, 0306/01, 0301/05, 0301/04, 0328/02, 0326/03, 0311/03, 0304/03, 0307/01, 0305/01, 0302/01, 0313/02, 0313/03, 0322/0, 0323/02, 0311/01, 0330/01, 0304/02, 0317/01, 0317/02, 0324/02, 0309/01, 0309/02, 0310/05, dhe 0313/01 në Komunën e Glllogocit, kjo pasi që nga provat e bashkangjitura nga ankesat e kandidatëve të Subjektit Politik PDK, rezultojnë se në vendvotimet e lartcekura të Komunës së Glllogocit, ka pasur parregullsi tek fletëvotimet e paplotësuar, rritje të numrit të fletëvotimeve të pavlefshme, mungesë të nënshkrimeve të disa komisionerëve në formularët e QNK, i cili pretendim përputhet me raportin zyrtar të KKZ, mospërputhje ndërmjet rezultateve të QNK-së dhe QNR-së, si dhe mungesë të transparencës gjatë procesit të rinumërimit.

Me dispozitën e nenin 15 pika 11.5 të Rregullës Zgjedhore Nr.-12/2024 - Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit parashihet se: *"11.5. fletëvotimet rinumërohen, për të vërtetuar nëse ka çfarëdo mospërputhje midis numrit të fletëvotimeve në kuti dhe numrit të nënshkrimeve në LV"*. Po ashtu me dispozitën e nenit 20 par.3 të Rregullës Zgjedhore 14/2024- Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) parashihet se: *"Në rast mospërputhjeje, me vendim të KQZ, Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) apo Gjykatës Supreme, rinumëron fletëvotimet"*. Ndërsa në nenin 21 par.7 të Rregullës Zgjedhore 16/2024 -Qendrat Komunale të Numërimit parashihet se: *"Anëtarët e*



ekipit të numërimit shënojnë në formular të rezultateve numrat e shiritave mbyllës të kutisë së votimit dhe nënshkruhen në formular të rezultateve, të krijuara nga ekipi i numërimit". Me dispozitën e nenit 106 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) Nr. 08/L-228, i cili decidivisht përcakton: "Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë cenuar me vendimin e KQZ-së, sa i përket shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, mund të parashtrojë ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga shpallja e tij".

Bazuar në dispozitat e lartcekura dhe nga provat në shkresat e lëndës, Paneli ka gjetur se në të gjitha këto raste ka parregullsi, pasi që nga konstatimet e vet përfaqësuesit të KKZ, është vërtetuar se në secilin ndërrim kanë marrë pjesë nga 9 ekipe me nga 4 anëtarë të cilët kanë qenë të subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ndërsa në formularët e QKN-së në shumicën prej tyre janë nënshkruar nga tre, dy apo më pak persona. Po ashtu nga provat e bashkangjitura ka mospërputhje të votave të paplotësuara dhe të pavlefshme për Kuvende Komunale në mes formularëve të Qendrave të Votimit me formularët e QKN-së, e që të gjitha këto fakte e bëjnë të pavlefshëm procesin e numërimit, pasi që janë arsye të besueshme se ka pasur ndërhyrje apo parregullsi gjatë përpunimit të të dhënave.

Andaj, Paneli duke u bazuar në arsyet e dhëna dhe në të gjitha shkeljet e theksuara më lartë, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi, duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 të LZP-së Nr. 08/L-228, i cili decidivisht përcakton: "PZAP-ja mund të urdhërojë rinumërimin e fletëvotimeve në një vendvotim apo qendër votimi si dhe shqyrtimin e materialit votues si pjesë të hetimeve për ankesën e parashtruar", si dhe Rregullores Për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave Nr.01/2025, neni 13 "në rast se PZAP konstaton se ka ndodhur shkelje e LZP-së dhe rregullave zgjedhore të KQZ-së para certifikimit të rezultateve zgjedhore është në kompetencë të PZAP që në raste të jashtëzakonshme: 12.1. të urdhërojë KQZ-në që të rinumëroj fletëvotimet në një vendvotim apo qendër votimi", andaj në rrethana të tilla PZAP me qëllim të evitimit të shkeljeve dhe parregullsive që janë evidentuar në këto qendra të votimit gjatë numërimit të fletëvotimeve, ka urdhëruar rinumërimin e këtyre fletëvotimeve.

Paneli vlerëson se KQZ-ja përkundër që ka pasur mundësi që përmes përgjigjes në ankesë të parashtroj prova dhe të argumentojë të kundërtën e pretendimeve të ankuesit, e njëjta nuk ka bashkangjitur asnjë provë për vërtetimin e pretendimeve të saj lidhur me parregullsitë e ndodhura në këto qendra të votimeve. Paneli ka vlerësuar deklaratimet e KQZ-së, se me vendimin e KQZ-së është urdhëruar rinumërimi në vendvotimet 0305/02, 0327/01 dhe 0329/02, nga ku kanë dal ndryshime në numrin e votave, e për të cilat në rastin konkret nuk është kërkuar rinumërimi në këtë rast, mirëpo sipas vlerësimit të Panelit kjo edhe më tepër e bazon qëndrimin dhe përbën edhe një fakt shtesë se numërimi në QKN nuk qenë i saktë dhe i rregullt.

Ndërsa sa i përket vendvotimeve me nr. 0305/02, 0327/01 dhe 0329/02 në komunën e Gillogocit, pas rinumërimit kanë rezultuar se në vendvotimin 0305/02 mospërputhja e rezultateve pas rinumërimit nuk ka ekzistuar, në vendvotimin 0327/01 është rritur toleranca +1, në mënyrë që vendvotimi të procedohet si i në rregull, ndërsa në vendvotimin 0329/02



pas rinumërimit të kutisë tek fletëvotimet e pavlefshme është gjetur një fletëvotim më pak sesa numri i shënuar në QKN, Paneli vendosi të mos i rinumëroj, pasi të njëjtat me vendimin e KQZ-së me Nr.01/2979-2025 të datës 22.10.2025, është bërë rinumërimi i fletëvotimeve dhe kështu që më nuk ekziston diferenca në mes të rezultateve, andaj dhe u vendos si në pikën II të dispozitivit.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, lidhur me aprovimin e pjesërishëm të ankesave të kandidatëve për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Gllogocit, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Bekim Lestrani dhe Besnike Fazliu, për shkak të parregullsive të pretenduara në shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 12 Tetor 2025. Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave Nr.01/2025. Kjo për faktin se Paneli për qendrat e vendvotimeve për të cilat ka vërtetuar se ka pasur parregullsi me vendimin e tij ka pranuar ankesat e ankuesve Besnike Fazliu, Fatmir Baliu, Murat Bylykbashi dhe Bekim Lestrani, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunal Gllogoc, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), pasi që nga provat e administruara ka vërtetuar se ka pasur parregullsi dhe mospërputhje të nënshkrimeve dhe fletëvotimeve në kutitë e votimit në vendvotimet: 0324/01, 0325/01, 0322/01, 0320/01, 0318/02, 0317/04, 0317/03, 0316/02, 0312/02, 0310/03, 0310/02, 0304/01, 0321/01, 0324/03, 0327/01, 0315/02, 0316/01, 0308/01, 0307/02, 0306/01, 0301/05, 0301/04, 0328/02, 0326/03, 0311/03, 0304/03, 0307/01, 0305/01, 0302/01, 0313/02, 0313/03, 0322/0, 0323/02, 0311/01, 0330/01, 0304/02, 0317/01, 0317/02, 0324/02, 0309/01, 0309/02, 0310/05, dhe 0313/01 në Komunën e Gllogocit, respektivisht në vendvotimet e lartcekura të Komunës së Gllogocit, ka pasur parregullsi tek fletëvotimet e paplotësuara, rritje të numrit të fletëvotimeve të pavlefshme, mungesë të nënshkrimeve të disa komisionerëve në formularët e QNK, i cili pretendim ka rezultuar se përputhet me raportin zyrtar të KKZ, mospërputhje ndërmjet rezultateve të QNK-së dhe QNR-së, si dhe mungesë të transparencës gjatë procesit të rinumërimit. Gjykata Supreme pretendimet e tilla i ka vlerësuar të pabazuara, kjo për faktin se të njëjtat nuk janë mbështetur në prova bindëse të cilat do të vërtetonin shkeljet e supozuara, kjo pasi që për vendvotimet për të cilat PZAP ka gjetur se ka pasur parregullsi, ka pranuar ankesat e tyre, duke urdhëruar KQZ-në që të rinumëroj të gjitha fletëvotimet për kandidatë për kuvend komunal në Komunën e Gllogocit, në vendvotimet e cekura si në pikën I të dispozitivit të vendimit të PZAP-së.

Gjykata Supreme vlerëson se PZAP, me rastin e vendosjes me të drejtë i është referuar nenit nënin 15 pika 11.5 të Rregullës Zgjedhore Nr.12/2024 - Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, i cili ka përcaktuar se: *"11.5. fletëvotimet rinumërohen, për të vërtetuar nëse ka qfarëdo mospërputhje midis numrit të fletëvotimeve në kuti dhe numrit të nënshkrimeve në LV"*. Po ashtu me dispozitën e nenit 20 paragraf 3 të Rregullës Zgjedhore 14/2024 - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është përcaktuar se: *"Në rast mospërputhjeje, me vendim të KQZ, Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP)*



apo Gjykatës Supreme, rinumëron fletëvotimet". Andaj Gjykata Supreme vlerëson se meqenëse PZAP ka gjetur parregullsi në qendrat e vendvotimit si në pikën I të dispozitivit të vendimit të tij, duke iu referuar dispozitave të lartcekura me të drejtë ka urdhëruar KQZ-në që në këto qendra të urdhërohet rinumërimi, që pastaj pas rinumërimit të fletëvotimeve për kandidatët për kuvendin komunal në Komunën e Glllogocit, të njëjtat të përfshihen në rezultatin përfundimtar. Po ashtu me nenin 21 paragraf 7 të Rregullës Zgjedhore 16/2024 - Qendrat Komunale të Numërimit pa është përcaktuar se: *"Anëtarët e ekipit të numërimit shënojnë në formular të rezultateve numrat e shiritave mbyllës të kutisë së votimit dhe nënshkruhen në formular të rezultateve, të krijuara nga ekipi i numërimit"*.

Ankuesit me ankesat e tyre kanë pretenduar se PZAP, nuk ka vendosur drejtë si në pikën II të dispozitivit të vendimit të tij, respektivisht për vendvotimet nr. 0305/02, 0327/01 dhe 0329/02, ka pasur parregullsi, andaj kanë kërkuar që në Komunën e Glllogocit, respektivisht vendvotimet e kësaj komune të urdhërohet në tërësi procesi i numërimit, mirëpo Gjykata Supreme këto pretendime i ka vlerësuar të pabazuara, kjo pasi që për vendvotimet në fjalë në Komunën e Glllogocit, ka rezultuar se pas rinumërimit kanë rezultuar se në vendvotimin 0305/02 mospërputhja e rezultateve pas rinumërimit nuk ka ekzistuar, në vendvotimin 0327/01 është rritur toleranca +-1, në mënyrë që vendvotimi të procedohet si i në rregull, ndërsa në vendvotimin 0329/02 pas rinumërimit të kutisë tek fletëvotimet e pavlefshme është gjetur një fletëvotim më pak sesa numri i shënuar në QKN, mirëpo ashtu siç ka theksuar Paneli, për këto vendvotime, me të drejtë është vendosur që të mos rinumërohen, kjo për faktin se të njëjtat me vendimin e KQZ-së me Nr.01/2979-2025 të datës 22.10.2025, është bërë rinumërimi i fletëvotimeve dhe kështu që më nuk ekziston diferenca në mes të rezultateve, andaj edhe pretendimet ankimore të ankuesve lidhur me atë se vendimi i PZAP-së është kontradiktorë, duke kërkuar që të urdhërohet rinumërimi i plotë i të gjitha kutive në Komunën e Drenasit, në këtë drejtim janë vlerësuar të pabazuara.

Gjykata Supreme e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të PZAP-it, kjo pasi që përveç se ankuesit nuk kanë arritur të provojnë parregullsitë për shkeljet e lartcekura në zgjedhjet lokale të 12 Tetorit 2025, po ashtu janë vlerësuar të paqëndrueshme edhe pretendimet tjera lidhur me atë se procesi i rinumërimit nuk është zhvilluar në përputhje me standardet e transparencës dhe paanshmërisë, duke ndikuar kështu që rezultatet e përfuara të mos përfaqësojnë realisht vullnetin e votuese, kjo pasi që Paneli në kuptim të nenit 117 paragraf 4 të LZP-së, Nr. 08/L-228, i cili ka përcaktuar se: *"PZAP-ja mund të urdhërojë rinumërimin e fletëvotimeve në një vendvotim apo qendër votimi si dhe shqyrtimin e materialit votues si pjesë të hetimeve për ankesën e parashtruar"*, si dhe Rregullores Për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave Nr.01/2025, me qëllim të evitimit të shkeljeve dhe parregullsive për vendvotimet për të cilat ka rezultuar se ka pasur parregullsi, ka urdhëruar rinumërimin e këtyre fletëvotimeve. Ndërsa për qendrat e vendvotimit për të cilat është refuzuar ankesa e ankuesve si në pikën II të dispozitivit të vendimit të PZAP-së, ka rezultuar se është bërë rinumërimi i fletëvotimeve dhe kështu që më nuk ekziston diferenca në mes të rezultateve, andaj edhe Gjykata Supreme e ka pranuar vendimin e PZAP dhe i ka refuzuar të pathemelta pretendimet e ankuesve në këtë drejtim.



Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme pretendimet e ankuesve për formën dhe përmbajtjen e vendimit janë të pabazuara, për faktin se vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, ndërsa edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë. Nisur nga gjendja faktike e vërtetuar, kolegji i kësaj gjykate konstatoi se në këtë çështje juridike, gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të parashtruesve të ankesës, prandaj, pretendimet ankimore janë refuzuar si të pabazuara. Kjo për faktin se si të tilla nuk dëshmuuan se përmbushin shkaqet për të cilat mund të paraqitet ankesa që të prezantohen fakte të reja nga pala e interesuar dhe, nuk u gjetën shkelje procedurale e as ndonjë gabim faktik i cili ndikon në të drejtat e palës apo ligjshmërinë e procedurës.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.116/2025, datë 14.11.2025

Kryetari i kolegjit,

Faton Bajrami



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
AKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRĐUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik
[Signature]



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS/ SUBJECI SAVETI KOSOVA/ KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



SEKRETARATI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës:
Oznaka spisa:

AA-116/2025
AA-117/2025

PLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL

DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLJANJE

1. Pasi marrësi, i cili me teminim e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dashur të bëhet dorëzimi I sa pas tënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kërkim e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërkësës, gjatë personit që punon po në atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatečen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavestjenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stani radnom mestu, dostava je izvršena: odraslom članu domaćin. Primaoca naslojniku zgrade susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtarit i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (dike e ngjitur në detyrë e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njegov domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stani - radnom mestu primaoca (pribiro na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____
dani _____ u _____ cas.
Shkakun i refuzimit të marrjes _____
Kazlog odbijanja prijma _____

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaoca

Emri i shkresës që dorëzohet:

Naslov pisma koja se dostavlja:

AKTIVIRANJE 14.11.2025
+12 FOLIOVIRANJE

Numri i shkojçave: _____
broj priloga _____

Vëretoi se mora shkresën e lartpërmendur
më (me folle)
Povrdujem prijem gorenavogonog pisma
(i slovima)

14.11.2025

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë atë në vend të tij
Përpis primaoca ili licu koje je
pismeno primilo u zamestu)

14.11.2025

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaoca

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë,
dorëzuesi, duke shënuar shkakun pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e tij.
Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpise, potpisuje ga dostavljaoca
napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.